



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 28.08.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllt rasti APK-DPKI-06-541/24, për zyrtaren e lartë znj. Albana Rexha, Kryesuese e Këshillit Drejtues në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur (sipas një raportimi) nën dyshimin për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Albana Rexha, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi ishte raportuar se znj. Albana Rexha, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, respektivisht Kryesuese e Këshillit Drejtues në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, ishte edhe përfaqësuese e autorizuar - Drejtoreshë në Organizatë Joqeveritare “Development Intiative”.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-01/572/24, duke e njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë. Më pas e njëjta është kontaktuar dhe sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, ajo nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese e autorizuar në Organizatë Joqeveritare(OJQ), sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkates për

shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.


Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtarja e lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke dekluaruar se do të ndërmarr veprime të menjëherëshme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, znj. Rexha përmes postës elektronike ka dërguar tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit Vendimin nr. 1499/2 datë 23.07.2024 në të cilin thuhet se: *Aprovohet kërkesa për ndryshimin e të dhënave – Shuarja e Organizatës Jo Qeveritare Development Initiative me Nr. Të regjistrimit 5113428-1, të cilën e përfaqëson znj. Albana Rexha Raça, përfaqësuese e autorizuar e organizatës.*

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:



Yll Buleshkaj

Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)